



# **PLATFORMA E FORUMIT TË GRUAS TË ALEANCËS KOSOVA E RE**

Forumi i Gruas i Aleancës Kosova e Re (FG AKR) është strukturë e cila vepron në kuadër të partisë Aleca Kosova e Re. Platforma e FG AKR-së bazohet në Statutin dhe në programin e partisë. FG AKR-ja më programin e saj paraqitet një faktorë shumë i rëndësishëm dhe me një rol kyq në politikat e AKR-së. Synimi kryesor i FG AKR-së do të jetë emancipimi i gruas në shoqërinë kosovare. Këto synime do të arrihen përmes politikave siq është.

## **GJENDJA E GRUAS NË SHOQËRINË KOSOVARE**

Liderët politik kosovar viteve të fundit proklamuan përcaktimin e tyre që të punojnë për implementimin e standardeve ndërkombëtare për ndërtimin e një shoqërie demokratike. Në këtë kontekst çështja e barazisë gjinore merr një domethënie më të madhe. Së pari pjesëmarrja e femrave është një ndër kriteret për matjen e suksesit të Kosovës në ndërtimin e institucioneve funksionale demokratike. Së dyti, dhe, me më shumë rëndësi, inkuadrimi i gruas në zhvillimet shoqërore është një parakusht i padiskutueshëm për zhvillim të suksesshëm të çdo shoqërie. Historikisht Kosova ka pasur një numër të vogël të pjesëmarrjes së femrave në zhvillimet shoqërore dhe në pozita vendimarrëse. Në veçanti, megjithë dispozitat mbi mosdiskriminimin në ligjin e aplikueshëm.

Jo vetëm në shoqërinë kosovare, por edhe në gjithë rruzullin tokësor rritja e ndërgjegjes mbi këtë fakt reflektohet në Deklaratën e Mileniumit (Millennium Declaration) dhe në Qëllimet për Zhvillim të Mileniumit (Millennium Development Goals) në marrëveshjen e arritur në mes të udhëheqësve botëror në shtator të vitit 2000, në Samitin e Mileniumit në selinë e Kombeve të Bashkuara. Deklarata e Mileniumit vendos vlerat të cilat duhet t'u prijnë zhvillimeve globale, lirisë, barazisë, solidaritetit, tolerancës, kujdesin për ambientin dhe përgjegjësitë e përbashkëta. Po ashtu premtan se duhet të lirojë “të gjithë racën njerëzore nga skamja”. Në deklaratë, liderët u zotuan që të “promovojnë barazinë gjinore dhe forcimin e gruas si rrugë e efektshme në luftë kundër vobekësisë, urisë dhe sëmundjeve duke stimuluar zhvillimin që është me të vërtetë i qëndrueshëm”.

## **GRUAJA NË KUADËR TË NORMAVE LIGJORE**

Në Korinzen Kushtetuese të Kosovës janë inkuadruar Konventat Ndërkombëtare më të cilat garantohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të përcaktuara në kapitullin e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Univerzale për të Drejtat e Njeriut, dhe Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave. Për më tepër, Korniza Kushtetuese në mënyrë specifike obligon Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes në Kosovë të “monitorojë dhe sigurojë të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të njohura ndërkombëtarisht”, të caktuara në instrumentet ligjore ndërkombëtare të cekura më lart.

Përkundër dispozitave të cilat promovojnë barazinë gjinore dhe jo-diskriminimin, të dhënat e fundit mbi përbërjen e shërbimit civil në Kosovë, tregojnë se femrat janë në masë të madhe të papërfaqësuar, e në veçanti në nivelin e lartë të vendimmarrjes. Për shembull, në vitin 2003 administrata komunale e Prishtinës e cila është më e madhja në Kosovë, përmbante 68.63% të meshkujve dhe 31.37% të femrave si shërbyes civil dhe nuk kishte femër drejtoreshë apo udhëheqëse të ndonjë sektori.

Indikator i rëndësishëm i cili tregon pozitën e gruas në shoqëri, është roli i tyre në proceset vendimmarrëse, si në nivelin politik ashtu edhe në atë administrativ. Platforma e Pekinit për Veprim shpallë siç vijon: “forcimi dhe autonomia sociale, ekonomike, politike e femrës, është esenciale që të arrihet një qeveri dhe administratë transparente e përgjegjshme si dhe një zhvillim i qëndrueshëm në të gjitha fushat e jetës. Arrtija e qëllimit të pjesmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në vendimmarrje do të ofrojë një balancim që në masë më të madhe kujdesshëm reflekton përbërjen e shoqërisë dhe nevojitet në mënyrë që të forcohet demokracia dhe promovimi i drejt i funksionimit të saj”. Platforma në mënyrë specifike kërkon që Qeveritë të “zotohen që të vendosin balancën gjinore në trupat qeveritare dhe komitete, si dhe në entitetet publike administrative, duke përfshirë *inter alia*, duke vendosur objektivat specifike dhe qëndrueshmërinë e masave implementuese në rritjen e numrit të femrave në mënyrë që të arrihet përfaqësimi i barabartë i meshkujve dhe femrave, nëse është e nevojshme edhe nëpërmjet të veprimit pozitiv, në të gjitha pozita qeveritare dhe ato të administratës publike”.

Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Kofi Ananit “studim pas studimi ka treguar se nuk ka një strategji të zhvillimit në të cilën femra nuk ka rol qëndror”. Kur femrat janë të inkuadruara plotësisht, përfitimet mund të shihen menjëherë, familjet janë më të shëndosha dhe të ushqyera më mirë, të ardhurat, kursimet dhe investimet ekonomike janë më të larta. Dhe kjo është në të mirë të familjes, komunitetit e më vonë në të mirë edhe të vendit”.

## **GRUAJA DHE FAMILJA**

Forumi i Gruas pranë AKR-së në radhë të parë synon ngritjen e vetëdijimit të familjeve kosovare, sepse pjesë përbërëse e kësaj shoqërie është gruaja. Ajo si një bashkëshorte, amvise, nënë, një nikoqire e mire mund të jetë shumë e dobishme për rrethin dhe shoqërinë tonë.

Qëllimi i FG AKR-së parasheh krijimin e një mjedisi sa më të sigurt dhe sa ma larg dhunës, çka do të sillte përfitime për të gjithë shoqërinë dhe për familjen, e jo vetëm për gruan.

## **GRUAJA DHE ARSIMI**

Mungesa e arsimit

Duke marr parasysh se në Kosovë nuk dihet numri i saktë i grave të paarsimuara, mirëpo dihen disa shkaqe që kanë ndikuar në mos arsimimin e gruas. Arsimi është një nga shtyllat fundamentale të një shoqërie të shëndoshë, me synime të avansuara demokratike do ta përkrahim dhe do të angazhohemi për implementimin e programit të arsimit të paraparë nga programi partiak i AKR-së, sepse, këtu shohim edhe shkollimin dhe emancipimin për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe politike.

Ne do të punojmë në vetëdijesimin e prindërve (sidomos të rajoneve rurale) që t'i dërgojnë vajzat në shkollë e sidomos në nivelin më të lartë duke mbajtur kurse, trajnime, seminare e deri te hapja e shkollave profesionale.

Siç dihet gruaja ende nuk ka rol të rëndësishëm në vendimmarrje, andaj ne do t'i inkurajojmë të konkurrojnë në të gjitha pozitat. Arsimiti i grave është i rëndësishëm pasi ai rritë kapacitetin e tyre me qëllim socializimin e brezit të ardhshëm, si dhe rritë potencialet e tyre për të kontribuar në aspektet sociale, ekonomike dhe politike të zhvillimit kombëtar.

## **GRUAJA DHE POLITIKA**

FG AKR-ja parasheh insistimin dhe bën përpjekje për një pjesëmarrje të gjerë të gruas në politikë. FG AKR-ja nuk insiston vetëm në numrin sasior që këkohet nga kjo pjesëmarrje, por insiston që të jetë niveli cilësor i këtyre grave që kontribuojnë në politikë, pra, FG AKR-ja kërkon detyrimisht kandidatura jo vetëm me arsim të lartë por edhe me kualifikime të veçanta.

Politika e FG AKR-së përkrah gratë intelektuale, energjike dhe të shkathta, që në profesionet e tyre deri më tani të papërfillura dhe të anashkaluara nga institucionet e deritashme, do ta kenë një derë të hapur e kjo është AKR-ja.

Roli i gruas në politikë po ashtu do të jetë edhe angazhimi për fuqizimin e përfshirjes edhe në strukturat vendimmarrëse.

## **GRUAJA DHE EKONOMIA**

FG AKR-ja në projektet e veta rëndësi të veçantë i kushton angazhimit të gruas në udhëheqjen e ndërmarrjeve të vogla, të mesme si dhe drejt angazhimit në udhëheqjen e ndërmarrjeve të mëdha. Gjithashtu, FG AKR-ja insiston që me projekte të veçanta të bëjë aftësimin e gruas, ku më së miri mund të vijë në shprehje aftësitë e tyre individuale.

Angazhimi i gruas në këto projekte do të mundësonte punësimin e shpejt të gruas, zbutjen e papunësisë si dhe ngritjen e dinjitetit të gruas, duke krijuar mundësinë e regjenerimit të të mirave materiale për një standard të qëndrueshëm, për të vazhduar drejt ngritjeve dhe ndërtimit të aftësive profesionale si dhe kyçja në proceset vendimmarrëse dhe inkuadrimi në problemet madhore.

Këto programe të udhëhequra nga FG AKR-ja i mundësojnë gruas të shpreh aftësitë e saja individuale për të vazhduar në mënyrë graduale edhe në bizneset e mëdha.

## **GRUAJA DHE KULTURA**

FG AKR-ja kulturën dhe sportin i sheh si ambasador bashkëpunimi me shtetet tjera, si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në atë regjional. Andaj, do të angazhohemi për shumëllojshmërinë kulturore të popujve të cilë jetojnë në Kosovë (begati shpirtërore dhe historike e çdo populli).

- Angazhimi për valorizimin e drejt të kulturës dhe historisë në mënyrë të barabart për të gjitha pa e injoruar kombin si veçanti kulturore.
- Angazhimi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, historike e fetare të çdo populli komform konventave ndërkombëtare.
- Mbrojtja e monumenteve kulturore historike-fetare.
- Stimulimi i kërkimeve arkeologjike dhe ekspozimi i tyre sipas periudhave në muzeun e Kosovës dhe në muzetë regjionale.
- Një kujdes dhe rëndësi kërkimeve arkivore për të kaluarën historike të Kosovës.
- Angazhimi për një pozitë me të volitshme në veprimtaritë botuese. Angazhimi për vlera të mirëfillta muzikore, veprimtari filmike, teatrale dhe të arteve.

## **GRUAJA ME AFTESI TE KUFIZUARA**

FG AKR-ja në kuadër të saj i parasheh këto objektivat dhe qëllime për gratë me aftësi të kufizuara:

- Gruaja dhe vajza me aftësi të kufizuara të ndaloj dhunën dhe diskriminimin e saj në familje, rreth dhe shoqëri.
- Të ndihet e barabartë në të gjitha sferat e jetës dhe e dobishme krahas grave tjera.
- Të merr pjesë në politikë dhe jetë publike.
- Të bashkëpunoj me Organizatat jo-qeveritare lokale dhe ndërkombëtare për çështjen e aftësisë së kufizuar.
- Përgatitja për jetë bashkëshortore, për krijimin e një familje të shëndoshë.
- Të organizoj fushata për ngritjen e vetëdijes mbi shkathtësitë e gruas me aftësi të kufizuar.
- Inkuadrimi i saj në biznese të vogla.
- Të ndihet e lirë dhe e pavarur në dhënien e mendimeve dhe opinionëve të saj.

## **GRUAJA DHE SHENDETSIA**

Forumi i Gruas së AKR-së në kuadër të politikës shëndetësore, si synim dhe objektivë kemi:

- Reformimin e politikës shëndetësore.
- Formimin e bazës ligjore shëndetësore.
- Sistemin funksional të sigurimit shëndetësor.
- Promovimin e shëndetit.

Forumi i Gruas së AKR-së synon përkujdesje permanente të sistemit funksional shëndetësor të çdo qytetari pa dallim kategorie, gjinie, racë etj.

Përmes harmonizimit të politikës shëndetësore, normave legjislative me standarde evropiane do të kontribuojme në:

- Shërbime shëndetësore.
- Përkrahje morale shëndetësore.
- Kujdes kualitativ.

Përfshirja e gruas në institucionet shëndetësore, duke filluar nga niveli parësor e deri në arritjen e instancave më të larta shëndetësore do të ndikoj në:

- Zbutjen e papunësisë.
- Parandalimin e trafikimit, drogës, prostitucionit, alkoolit, duhanit, etj.

Qëllimi ynë është përkrahja shëndetësore:

- E të mbijetuarve të torturës.
- Avancimi i edukimit të shëndetit mental.
- Shëndetit reprodutiv.
- Zhvillimin i aktiviteteve kulturore shëndetësore.